



*Elisa Iljazi*

*Çelësi i lumturisë*

*Tetovë  
2023*

*Elisa Iljazi*

# *Çelësi i lumturisë*

*Tetovë, 2023*

*~ 1 ~*

*Botues: Luma Grafi-Tetovë*  
*Autorja: Elisa Iljazi*  
*Titulli: Çelësi i lumturisë*  
*Redaktor: Muaxher Haruni*  
*Recensent: Behare Neziri*  
*Lektorë: Rami Kamberi*  
*Korrektor: Fiknete Nesimi*  
*Radhitja & dizajni : Emin Haruni*  
*Shtypi: Luma Grafi-Tetovë*  
*Tirazhi: 100 kopje*

*Botimin e librit financiarisht e mbështeti Kryesia e Shoqatës së  
Shkrimtarëve “OENEIM”-Tetovë*

*“Edhe nëse je njeriu më i pasur në botë, ti nëse nuk ke ndërgjegje, thjesht një hiç je.”*

*“Ndonjëherë njerëzit janë shumë kryelartë, kryelartësia e tyre një ditë do ti ul shumë poshtë.”*

*Elisa Iljazi*

Të nderuar adhurues të fjalës së bukur, të nderuar e të respektuar lexues të krijimeve të mia, ju prezantoj librin tim të dytë me poezi, te i cili jam munduar të krijoj poezi me tematikë të njëjtë ose të përafërt me librin e parë, por me një qasje krejt ndryshe nga libri i parë si në cilësi po ashtu edhe në brendi të krijimeve të mia.

Në këtë vepër mund të gjeni vetveten tuaj, sepse ky libër ka oazat e dashurisë së vetes suaj, ka ato pika kryesore të cilat një njeri duhet të tregohet i fortë pavarësisht se sa jeta e sfidon, andaj ky është libri që jep frymë pozitive, ngrohtësi, dhe vazhdimësi në të ardhmen e një njeriu, tregon se vlera e vetes është e rëndësishme ngase tregon se dashuria e të ardhmes nuk mbaron vetëm duke u rrëzuar dy tre herë e duke u ri-ngritur përsëri.

Të mëson më shumë, të bën të ndihesh sikurse që rilindur sepse e rëndësishmja është jeta dhe vetja jote, të bën të jesh më i durueshëm dhe të qeshi vetëbesim në vetvete.

Motiv për këtë vepër nuk më dha vetja këtë radhë, por më dhanë njerëzit që përpigën të arrijnë diçka por diçka i ndalon, më dhanë ata njerëz që ia kanë menduar më të keqen vetes, apo ato njerëz që kanë tentuar të largohen nga të dashurit e tyre.

Çelësi i lumturisë tregon ngjarjet e vërteta, që edhe në përditshmëri ndodhin dhe, sidomos që ndodh tek rinia e sotme.

Andaj unë në këtë vepër kam dashur të shpreh vullnetin e njerëzve, kam dashur t'u jap forcë çdo kujë që mendon se nuk mund të arrijë diçka vetëm për një gabim. Më besoni, ju gjithçka mund të arrini në kohën e duhur dhe, në kohën e caktuar, ju sërish mund të rilindni dhe t'ia filloni nga e para sepse edhe ju jeni njerëz dhe ecni mbi tokë.

Këtë libër ia dedikoj Nënë sime, të cilën nuk e harroj sa të ekzistoj kjo botë dhe e cila më dha e më jep kurajë për të vazhduar më tutje në jetë pa marrë parasysht pengesat e nënkëmbëzat që më dalin gjatë jetës.

Me respekt:

Elisa Iljazi

## *A nuk jam një grua*

*Duroj fatkeqësitë në këtë botë  
Pa më thuaj a nuk jam një grua,  
Duroj dhimbjet në këtë tokë  
Më thuaj a nuk jam një grua.*

*Pastroj vendet e pa lara  
A nuk jam një grua,  
Gjithmonë e fortë duke ecur përpara  
Më thuaj a nuk jam një grua.*

*Në zemër mbaj dhe duroj  
Pa më thuaj a nuk jam një grua,  
Një ditë do të jem e lirë po shpresoj  
Më thuaj a nuk jam një grua.*

*Fëmijët i edukoj e i mbroj  
A thua vallë nuk jam një grua,  
Ata më së shumti i dashuroj  
Më thuaj a s'jam një grua.*

*Punën time me nder e respektoj  
A thua vallë s'jam një grua,  
Familjen time nuk dua ta turpëroj  
Më thuaj ti a s'jam një grua.*

## *A thua vallë*

*A më mendon mua ndonjë herë,  
A të shkon mendja tek unë,  
Ose tash më shikon vetëm me vrer,  
A thua vallë më urren,  
Tash zemra e di që të dhemb,  
Çfarë të bëra më trego,  
Desha në një sallë të madhe  
Nën dritat shndritshme  
E vetme me ty të vallëzoi.*

## *Sikur jeta të ishte poezi*

*Jam ulur në cepin e dritares  
Në një copë letre po shkruaj,  
Jam sikur një pjesë e një petale  
Poezinë në zemër e rruaj.*

*Jashtë binte shi  
Thosha sikur jeta të ishte një poezi,  
Po shkruaj vjersha në vargje po i realizoj,  
Mundohem që të tjerët  
Nga poezitë e mia diçka të mësojnë.*

*E dashuruar pas një të ardhme  
Po mendoj se a do arrij,  
Me mund, me forcë do mundem të ia dal  
Shpresoj nesër t'i kem gjërat e mija në vijë.*



## *Ajo duro*

*Ajo duroi fjalët e dhimbjet,  
Ajo duroi hallet e bindjet.*

*E lënduan, ajo i falë,  
E copëtuan, sërish besoi,  
E mbytën për së gjalli, e shkatërruan  
Ajo zemër tash është e verbuar.*

*Ajo sërish u bë e fortë, duroi,  
Atë zemër e arritën ta shkatëhojnë,  
Qau, luftoi e vetme gjithçka përballoi.*

## *Asgjë rastësisht*

*Për atë nuk ishte ëndërr  
Për atë nuk ishte as dashuri,  
Asaj zemra i rrihte për një ardhmëri  
Eh, kjo pra nuk ishte as një rastësi.*

*Deshi sfida në jetë të sfidoj  
Sa që ndonjëherë qante me lot,  
Por kur nuk u dorëzua  
Ajo në veten e saj u betua.*

*Asgjë e rastësishme nuk ishte  
Ajo po ajo donte të arrinte,  
Kishite dëshirë të studiojë  
Kohën asnjëherë qot se harxhoi.*

*Po ajo ndoshta diçkë edhe gaboi  
Por për të tjerët asnjëherë nuk i interesoi,  
Diçkush shpifi e diçkush e donte  
Nuk i interesonte absolutisht  
Kush dhe çfarë i ofronte.*

## *Aty ku s'jam unë*

*Thashetheme ka çdo kund  
Aty ku s'jam unë,  
Njerëzit më shajnë  
Përpara meje hallet qajnë.*

*Aty ku s'jam unë  
Ka gënjeshtra e mashtrime,  
Me mimiqa shtiren, bëjnë veprime,  
Aty ku s'jam unë  
Qeshin tallen se fjalën e bukur e krijoj  
Kurse ata për gjera të pavlera bisedojnë.*

*Aty ku s'jam unë,  
Përmenden gabimet e mija,  
Thonë: si e mban shtëpia,  
Aty ku s'jam unë,  
Ka inate e xhelozë,  
A më pyete ndonjëherë,  
Se sa interes kam për ty.*

## *Besoj*

*Besoj se jeta ka sakrificë  
E di janë ato sfida që dëshiron të të pëlcastin,  
Por e besoj se ka shumë batica  
Në botë shumë gjëra do të hasim.*

*E besova edhe ata që më lëndoi  
E besova ata që më mërzi,  
E besova edhe ata që më dashuroi  
Më mësuan se kjo qenka jeta.*

*Aq shumë në jetë besova  
Sa që dashurin anë e mbanë e kërkova,  
Sa që tash më shumë se një i rritur mësova  
Tash unë e di edhe ku gabova.*

## *Biri im*

*I dashur i vogli im bir  
Ti lindre e shpirtin më gëzove,  
Ti erdhe ne jetë duke me befasuar  
Ti më mësove çfarë do të thotë të jesh e dashuruar.*

*Lindja jote gëzoi qiellin dhe tokën  
Biri im unë të dua më tepër se botën,  
Zoti më dërgoi dhuratë më të çmuar  
Ti je ai, biri im, që zoti më pati dhuruar.*

*Ti erdhe sikur një melodi  
I hape dyert e zemrës të të dua vetëm ty,  
Zoti më dërgoi një pishtar në lundrën e dashurisë  
Se sa e vërtet qenka dashuria ndaj fëmijës!*

## *Borxh*

*Si do ta shpaguash ti borxhin tënd  
Duke më vrarë,  
Unë nuk e harroj do ta mbaj gjithmonë mënd  
Vetëm duke qarë.*

*Si do të më dalësh përpara syve të mi  
Duke buzëqeshur,  
Apo duke mos pasur më lumturi  
Do më dalësh përpara duke heshtur.*

*Më ke borxh një jetë  
Ti njeri që më gjykoje,  
Që më gënjeve dhe nuk m'i the gjërat me të vërtetë  
Ti që të drejtat e mija i anashkaloje.*

## *Bukuria*

*Ç'vlerë ka kjo bukuri  
Kur në shpirt nuk ke lumturi,  
Çfarë të duhet ajo dukje  
Kur karakterin e ke në zhdukje.*

*Për çfarë shërben gjithë ajo çmenduri  
Të rringrihesh më lartë,  
Por brenda je e mbushur me mëri  
Shikon veten çdo ditë në pasqyrë.*

*Pse tregohesh se je dikush  
Bukura e jashtme të jep mendjelehtësi,  
Edhe pse këtë e bën gjithkush  
Të gjithë kemi në këtë botë bukuri.,  
Po ajo është brenda në zemër  
Sepse nuk je ti e vetmja femër.*

## *Dashuria jonë*

*Po rifilloj të shkruaj për dashurinë tonë,  
Atë që asnjëherë nuk e lash për më vonë,  
Po flas për një person i cili më ndriçon jetën,  
Që asnjëherë nuk më tha të pavërtetën.  
Copëzat e letrës që shkruaj për ty,  
I rruaj sikur dy sytë e mi,  
Të dua zemra ime, të dua,  
Shpresoj se ti je i lindur për mua.  
Sot shtatë muaj bashkë,  
Asnjëherë me mua nuk ishe i vrazhdë,  
Dashuria jonë nuk krahasonhet.  
Ne jemi dy që po fitojmë  
Të dua aq sa malet,  
Besomë se dashuria ime asnjëherë s'do të ndalet!*



## *Dikur*

*Dikur ne,  
Kurse sot vetëm.  
Ëndërronim të vraponim dorë më dorë  
Të kalojmë çdo rrugë bashkë,  
Por tani po vjen dimri  
Këtë dashuri po e kaplon e madhja borë.  
Dikur ishim ne  
Që vajtuam,  
Dikur ne  
Që së bashku jetën deshëm ta jetojmë,  
Kurse sot  
Më se di çfarë do të thotë e dashuruar.*

## *Ditë e re*

*Në mëngjes agoi dielli  
Tregoi se sot është një ditë e re,  
Lartë i kaltër gjysma e qiellit  
Për ne vajza, vetëm për ne.*

*Të duam të punojmë  
Fëmijët tonë nesër t'i mësojnë,  
Të ardhmen tonë ta krijojmë  
Gjëra të rreja të zbulojnë...*

## *Do të kërkoj*

*Do të kërkoj deri sa dita të bëhet natë,  
Do të kërkoj deri sa unë të fitoj,  
Do të kërkoj e di se duhet shumë punë,  
Do të kërkoj në gjithë kontinentet e botës,  
Do të kërkoj edhe rreth e me rreth tokës,  
Do të kërkoj nga veriu në jug,  
Do të kërkoj deri sa të më mbyllin në burg,  
Do të kërkoj ty do të kërkoj,  
Për lotët që derdha ty do të denoncoj.*

## *Dritë mbi plagë*

*Sa ditë të zeza njeriu kalon  
Dhe sërish drita mbi të mbizotëron,  
Sa net pa gjumë ai po bën  
Mbi të gjitha sërish gjen forcë e jeton.*

*Sa muaj sa vite përpiqet të jetë i fortë  
Dhe sa herë që mundohet sërish ia del,  
Dritë mbi plagë sërish lëshon  
Dhe thotë “Jo aqoma nuk është vonë”.*

*Sa i fortë nuk dorëzohet  
Askujt në jetë nuk i ankohet,  
Brendësinë e mban në zemrën e vet  
Por shpirti i tij asnjëherë s’pushon i qetë.*

*A më thoni se a ia dini vlerën vetes  
Si përballeni me gjithë sfidat e jetës,  
Ti sërish zgjohesh në mëngjes duke qeshur  
Brendësin tënde nuk e shpreh qëndron i heshtur .*

*Dritë mbi plagët e tua lëshon  
Hëna aqoma rrezet e saj ndriçon,  
Dielli lind e perëndon  
Ti bëhesh i fortë sepse ashtu zoti të sprovon.*

*E di fatin tim*

*E di fatin tim*

*Që duhet me pritë,*

*Të ma rregulloj problemin tim*

*Edhe nëse do kaloj një vit.*

*E di fatin tim*

*Pse ju po më tregoni,*

*Kjo është jeta ime*

*Pse duhet të më gjyqoni.*

*E di se fati po më pret*

*Dashurinë ai do ma tregoj,*

*Duqë ecur det më det*

*Edhe nëse do mundem do ta sfidoj.*

## *E di*

*E di se një ditë do ndryshoj çdo gjë,  
E di se një ditë kjo botë ka për tu bërë,  
E di se jeta e disa njerëzve do të jetë e bukur,  
E di se njerëzit nuk do të jenë të strukur,  
E di se dashuria do të jetë e vërtetë,  
Por më besoni, të këni në vete pak shpresë,  
E di se do vuani në fillim,  
Por më besoni se edhe vuajtja ka mbarim,  
E di se nxënësit do të kenë interes për mësim,  
Për besë një botë tjetër na pret në vazhdim,  
E di se do mbyllen shumë burgje,  
Por do hapen shumë shkolla,  
Martesa do e ketë vendin e saj,  
Vajzat nuk do qajnë më  
Për një mashkull s' do derdhnin lot,  
E di se nderi do të rruhet dhe të ketë mbarësi,  
Por dëjani ajo ditë do vi  
Kur e vërtet do bëhet ajo dashuri.*

## *E. fortë si gurë*

*Grua i tha vetes  
Duroj të padrejtat,  
Qau, por tha se ishin sfidat e jetës  
Duroj edhe të pavërtetat.*

*Ajo ia doli se ishte e fortë  
Ajo grua me fëmijë u la në rrugë,  
Të tjerët nuk ju dhimbën dot  
Vetëm nga një i poshtër që nuk u quajt burrë.*

*Për fëmijët e saj duroi edhe dhunimin  
Ajo nënë e shkrret lotët nuk mund t'i ndalte,  
Ajo vetë e rriti jetimin  
Edhe bukë e krip ajo hante,  
Përbuzjen e nënçmimin nuk e duronte.*

## *E kudo ndodhura*

*Atje isha tek një oqean  
Duart dhe këmbët nuk po më mbanë,  
Aty pash veten në të vërtetë  
Aty kuptova çfarë do të thotë jetë.*

*E kudondodhur në çdo hap  
E di po kulloja në djersë  
Sepse ishte shumë vapë,  
Kuptova se duhet të mësoj  
Në çdo vend e kudondodhura qëndroj.*

*Sepse ajo ëndërronte  
Veten e saj e pikturonte,  
Ajo deshi të jetë më e drejtë  
Ajo ishte e kudondodhura në të vërtetë.!*



## *E. padrejtë*

*Ju ofendoni pa të drejtë  
Gjithkënd me vetëdije lëndoni,  
Dikë e bënë ti rrjedhin lotët  
E dikë shpirtërisht lëndoni,  
Pse e paragjyqoni se çfarë dëshiron të jetë  
Juve thashethemet ju kanë mbet.*

*Pse bëheni pa zemër dhe poshtëroni  
Në rregull nëse nuk e doni mos e shoqëroni,  
Pse duhet ajo të futet në depresion për kotë  
Si kërjt dëshiron të jetoj në të njëjtën botë.*

*Padrejtësia sot po mbizotëron  
Njeriu njeriun nuk di ta respektohen,  
Sa të liga ka jeta  
Njerëzit u besojnë të pavërtetave.*

## ***E shikën ku ka arritur ajo***

*Atë që ti e dije tradhtare  
Atë që ti e dije gënjeshtare,  
E shikën është në qiellin e shtatë  
Ajo qëndrojt gjithmonë e fortë.*

*Atë Zoti e nxori në dritë  
Për atë nata u bë ditë,  
Po ti a thua si jeton  
A thua vallë ndonjëherë e mendon?*

*Hë pra mos gënjej  
Kur e dije se s'kishite faj,  
Vetëm deshe ta largosh  
E le të shkëtuar si dhe me lotët vaj  
Ajo sakrifikoj për ty  
Ajo zgjodhi dashuri.*

*Ajo qau kur ti e ofendove  
Ajo ishte e lumtur,  
Kur ti një përqafim ja dhurove  
Ajo të dedikoj veten  
Ndërsa ti ja more jetën.*

*A aq i padrejtë u tregove  
Një grua si e dhunove,  
Si arrite ta lësh duqë e ditur se si është  
Si munde ti këtë ta bësh.*

*Ajo ka arritur në majën më të lartë  
Ajo më ka shënuar çdo datë,  
Ajo e ka cakëtur jetën e saj  
Me fat do të jetë ai njeri që do ta ketë çdo natë.*

*Ajo po, po ajo  
Ja doli sepse ishte grua  
Sepse ajo çdo natë bënte dua.*

## *Ëndërroj*

*Ëndërroj kur fle, kur qajë,  
Ëndërroj edhe nëse lotët më shkojnë sikur lum,  
Ëndërroj të jem ajo dikush  
Këtë s'mund ta bëj gjithkush.*

*Ëndërroj natën çdo herë  
Ëndërroj një botë me ngjyra,  
Edhe nëse dikush  
Ëndërrën time e shikon me vrer  
Kam pa njerëz me shumë fytjyra.*

## *Është bukur të jetosh*

*Dielli ndriçon çdo mëngjes  
Të tregon se sot për ty ka një shpresë,  
Hëna është me ty kur je duke fjetur  
Të jep dritë të mos jesh e vërejtur.*

*Yjet janë aq shumë, me mijëra  
Ata jam që plotësojnë dëshira,  
A nuk e shikon sa e bukur është jeta  
Nuk të gënjen të tregon të gjitha të vërtetat.*

*Qielli i kaltër çdo herë i lumtur  
Ktheje pak kokën jashtë ka njerëz të vuajtur,  
Thuaj faleminderit për këto  
Kohën me lot mos e shpenzo.*

## *Gjithmonë ka një shpresë*

*Duron, qanë, vajton  
Por sërish thua;  
Jeta po vazhdon,  
Nuk je e lumtur,  
Nuk buzëqesh,  
Por mos harro e dashura ime  
Gjithmonë ka një shpresë.*

*Nuk dëshiron të jetosh  
E urren vetveten  
Por të lutem mos e fajëso jetën,  
Jeta nuk të bën të urresh veten  
Ajo të mëson të besosh në të vërtetën.*

*Lodhesh, nuk ke fuqi të besosh  
Por të lutem bëhu e fortë  
Ka aqoma shanse që të shpresosh,  
Mos e dëgjo çfarë ka thënë dikush për ty  
Në qoftë se je e pastër jeto në lumturi.*

*Më beso gjithçka do kaloj  
Edhe pikëllimet do mbarojnë,  
Do jesh lartë e më lartë  
Më beso ti do kesh fat.*

*Mos e mbytë vetveten për dikë tjetër  
Lëre pas kohën e vjetër,  
Beso në vetvete se do ia dalësh  
Mos thuaj vetes nuk mund t'ia falësh.*

*Çdo kush gabon  
Çdo kush pa dashje dikë e lëndon,  
Pavarësisht si ka vajtur, ti sërish njerëzit i dashuron  
Dhe për gjithçka në këtë botë shpreson....*

## *Hënë ndriço*

*Hënë bën dritë mirë  
Që të shohim sa më mirë,  
Të mësojmë çdo herë në jetë  
Ty të të duam me të vërtetë.*

*Hëna ime ndriço  
Gjëra të rreja ti na mëso,  
Yjet lartë të ndriçojnë  
Rrugën neve të na tregojnë.*



## *Herë këndej e andej*

*Herë në fushë herë në mal  
Ti më more shpirtin,  
Unë mendoj për atë djalë  
Si një luleje kur i bie fryti.*

*Herë në atë anë herë në këtë anë  
Ti moj kohë e vjetër  
Më kujton me mall,  
Oj copëz hënë oj dritë e perëndisë  
Më fal pak nga copëza e rehatisë,  
Më kap vreri për një çast  
Ti o njeri me zemër të zezë  
A thua vetëm ti më ke dashtë.*

## *Heshtën*

*Heshtën mësuesit,  
Ikën nxënësit.*

*Heshtën ata që duhet të flisnin,  
Largimin e rinisë po e prisnin.*

*Heshtëm të drejtët,  
Folën ata të padrejtët.*

*Heshtën e ulnin koka,*  
*Tash po përlëshen me botën.*

*Heshtën demokracitë,  
Tash po rrisin kryelartësinë anarkistët.*

*U bënë padrejtësi,  
I gënjyen pa vërtetësi.*

*Disa mësonin,  
Ata diturinë që e kishin nuk i punësonin.*

*Tash flisni se të rinjtë po largohen,  
Nga ju popull i dashur po mësohen..*

## *Jam vetëm*

*Po qaj, po qaj*

*Lotët më rrjedhin sikur vaj,*

*Jam e vetme e mbyllur në shtëpi*

*Nuk dua të dal t'ia di për lumturi.*

*Aspak nuk dua të flas*

*Dhe askush nuk dua të më thërras,*

*Të gjithë të duan për interes*

*Askush nuk të thotë "Eja se po të pres".*

*Askujt nuk i intereson ku je*

*Së fundi hallët e tua nuk duhet t'ia qash të tjerëve,*

*Por po çmallëm me këtë poezi*

*Tregova se njerëzit s'kanë më dashuri.*

## *Kaloi*

*Kaloi dete, kaloi male  
Kaloi tokën, kaloi qiejt,  
Kaloi sprova, kaloi halle  
Kaloi botën, kaloi dije.*

*Ajo kaloi të vështirën  
Kaloi brenda humnerës,  
Ajo kaloi tokën  
Ajo kaloi gjërat rreth e më rreth botës.*

*Ajo qau, ajo vajtoi  
Jetën e pati të vështirë,  
Nga gabimi shumë mësoi  
Askush për të s'pati mëshirë.*

## *Kanarina në dritare*

*Cicërimat e saj nuk pushonin  
Ngjyra ngjyra njëjtë si lulet,  
Vetëm mua nga gjumi deshi të më zgjoj  
Ajo kanarinë në dritare qëndronte ulur.*

*Cicëronte aq bukur si një melodi e re  
U mahnita kur e pash,  
Kanarina na tregonte se kishte punë për ne  
Në sy mu duk sikur një vashë.*

## *Kjo botë*

*Kjo botë është kaç e vogël  
E njerëzit të përdorin si lodër,  
Ka shumë probleme e fatkeqësi  
Askush nuk flet se si të rikthej lumturinë.*

*Kjo botë kaç e kotë  
Si mundet vëllai vëllanë mos e duron dot,  
Nuk duhen njerëzit, nuk respektohen  
A thua vallë kështu një familje krijohet.*

*Kjo botë me plot intrigë  
Si po i duron gjithë këta njerëz të ligë,  
Si po i mban njerëzit mbi tokë  
Ah!  
Sa e mjerë qenka kjo botë...*

## *Kjo poezi*

*Kjo poezi që po e shkruaj  
Këtë poezi në zemër do ta rruaj,  
Kjo poezi që ti po e lexon  
Mendo sepse dikush për ty po sakrifikon.  
Kjo poezi që netëve të mia u fal dashuri  
Kujto se një ditë do të dalësh nga ajo palumturi,  
Kjo poezi që ti asnjëherë nuk ke lexuar  
Nuk do kesh as kohë më për të dashuruar.  
Kjo poezi që të bën të lotosh  
Bëje qëllimin që ke nuk do dështosh,  
Kjo poezi që të inspiron  
Më beso kjo poezi jetën ta ndriçon.  
Kjo poezi që ti mendon se nuk ka vlerë  
Por dije është më e mirë se sa të trokasësh derë më derë,  
Kjo poezi që po të mbush ty  
Kjo është për pak lumturi.  
Kjo poezi e cila të dominon  
Veten me askënd mos të krahasosh të tregon,  
Kjo poezi që ti e din sikur një shkrim kot  
Më beso se nuk do të të shoh me lot...*

## *Ku janë*

*Ku janë ëndrrat që i ëndërrova,  
Ku është dashuria që ta dhurova,  
Ku janë premtimet që mi the,  
Ku është zemra që ma dhe,  
Ku është besa dhe ndëshkimi,  
Ku është loti dhe vajtimi,  
Ku je futur në atë errësirë,  
Kë humbur edhe atë zemër të dëlirë,  
Diell i ndritshëm, diell i rremë,  
Në sytë e mi më vjen,  
Të të shikoj vetëm me vrer.*



## *Kurbeti*

*Si na thave lotët  
Si na dogje për së gjalli,  
Kurbeti të bën të presësh motet  
Ah more kurbet na mbyte nga malli.*

*Familja nuk gjendet, larg kanë udhëtuar  
Jetën më mirë për ta kaluar,  
Ah more kurbet familjen  
Këtu dëshiroj ta kem,  
Nga malli zemra po më plas.*

*I more krejt e nuk di me na kthye  
Si mundet të qëndroj  
Familjen me sy të mos e shikoj,  
Ti kurbet na shkatërrove  
Ti kurbet neve na harrove.*

## *Lamtumir atdheu im*

*Lash male ,lash toka  
Unë e lash atdheun tim,  
Tash po më rrethon bota  
Lamtumir atdheu im.*

*Po më djeg në zemër ti  
Si hoqa dorë për atdheun tim,  
Nga këtu prej në mërgim  
Atje linda atje u rrita  
Diku tjetër nuse zbrita.*

*Lamtumirë me plot kujtime  
Atje ku kaloj rinia ime,  
Lamtumirë me lot në sy  
Disa vargje ti kushtova ty.*

## Lamtumirë

Ah sa lot po shoh sot  
Kohën nuk e ndaloj dot,  
Ju po shikoni  
Më neve nuk do të na takoni,  
Ah sa e vështirë kjo lamtumirë  
Për ata arsimitar që ishin aq të mirë.  
Shumë kohë të bukur kaluam  
Ju jeni ata, që neve na mësuat,  
Ata që asnjëherë nuk u dorëzuat,  
Brezat e rij duke i edukuar.  
Tash më erdhi koha të largoheni  
Shpresoj në të ardhmen sa më shpesh të takohemi,  
Gjithë këto vite kaluan shumë shpejtë  
Ju gjithmonë na mësuat në të drejtë.  
Na mësuat diturinë  
Ne të krijojmë ardhmërinë,  
Na mësuat të respektojmë  
Njerëzit në botë ti nderojmë.  
Ju jeni pishtar që s' shuheni dot  
Në çdo gjë për ne derdhët mund,  
Të ju themi faleminderit është pak,  
Ju kërkoj ndjesë nëse ju këmi hyrë në hak,  
Ju faleminderit që na mësuat rrugën e drejtë  
Që nesër të vetëm rrugëtimin tuaj të ndjekim,  
Për ju tash fillon një jetë e rre  
Kurse pikëllim vazhdon për në.  
Lamtumira është e vështirë  
Por ju po bëheni pensionistë të mirë,  
Tash më i erdhi dhe fundi  
Ju që e dhatë tërë mundin  
Tash po ju themi LAMTUMIRË  
Një rrugëtim i gjatë që tash është i vështirë!

## *Lulëkuqja*

*Ti më dhe dritë, ti më dhe fat  
E di, unë të mendoj çdo natë,  
Lulëkuqe të them se të dua shumë  
Ti e di zemra pa ty mu bë shkrumb.*

*Lulëkuqja me ngjyra  
Aromën më të mirën cenon  
Me dashuri ajo gjithmonë më dënon,  
Ah moj lulëkuqe më lë pak hapësirë  
Sikur sot të mos e këm më vështirë*

## *7 Marsi*

*Një lule e bukur mu sikur ti  
Për ty arsimitare, për ty,  
Që më dhe kaq dituri  
Pa ty jeta nuk do kishe aspak lumturi.*

*7 Marsin ta urova  
Nëna e dytë për mua,  
Një buqetë me lule ta dërgova  
Edhe ti më mësove të të dua.*

*Detyrat bashkë i punonim  
Në një klasë pesë orë qëndronim,  
Asnjëherë njëri tjetrin se dallonim  
Ti na mësove edukatë të këmi.*

## *Urime 8 Marsi Nënë*

*Pse nuk ndriçon kjo hënë  
Edhe unë 8 Marsin doja të të uroj,  
Por tash nga parajsa po të shikoj  
Desha të të dhuroj një buqet me lule,  
Desha të të pyes se ti me mua a u mburre  
Nënë ah sa shumë po mungon,  
A sa shumë ky sy po loton  
Thash mos ndoshita të kam gëzuar,  
Mos ndoshita arritjet e mija të kanë lumturuar,  
Nënë 8 marsin nuk mund të të uroj  
Vetëm nga qielli sytë po ti shikoj,  
Më ka marr malli me të thënë*

*Se je dashuria më e madhe në jetë,  
Edhe pse pa ty shkuan shumë vjet  
Kam pas nevojë të të tregoj një hall,  
Kam pas nevojë të të tregoj*

*Se po mbyt ky mall,  
Po mungon era jote çdo ditë  
Por moss haro unë të kujtoj çdo vit,  
Nënë më ka marr malli të më ushqesh  
Më ka marr malli zërin të ta dëgjoj,  
Edhe tash unë po të uroj  
Edhe sa të kem jetë fytyrën tënde do ta kujtoj..*

## *Malli*

*Malli më mbyti  
Zemra më bërtiti,  
Ah dashni po më mundon  
Shpirtin ma përvelon.*

*Loti më rrjedh nga syri  
Një zjarr në zemër të thërriti,  
Ah dashni sa e vështirë ishte ti  
Edhe ditën ma bëre erësirë.*

*Zgjohem në mëngjes  
Kur të shkruaj bëmë kujdes,  
Ah dashni për ty veten harrova  
Dua të ikij të vijë tek ti.*

*Të dua shumë  
Sa që tërë natën rri pa gjumë,  
Fle që të ëndëroj  
Se vetëm ty të dashuroj.*

## *Me plot sfida*

*O hënë e bukur që ndriçon  
Pa më thuaj mua,  
Pse jam e venitur  
Vetëm atë do e dua.*

*O yjet e mi me plot shkëlqim  
A jeni ata që më dhatë pak mësim,  
Këtë rrugë të pakuptim  
Që mësova vetëm me trishtim.*

*O diell me rreze aq të forta  
Në këtë tokë ka femra shumë të dobëta,  
Mësova se reja ka mbuluar sytë e mi  
Jam e verbuar shikoj vetëm vetmi.*

*Retë e errëta o re  
Pse për mbi mua ka dhe,  
Pse po ndihem e vetmuar  
Kuptova se sa keq qenkam dashuruar.*



## *Mes dy botëve*

*Të kesh dy botë një imagjinatë  
Do shkoja në çdo vend  
Duke vizituar një hartë,  
Mes tokës mes qiellit  
Diku larg po perëndonte dielli.*

*Mes dy botëve unë jam  
E rrethuar me dashuri anë e mbanë,  
Të dashurosh aq sa malet  
Asnjëherë zemra mos të ndalet...*

## *Mos u mërzit*

*Vazhdo jeto*

*Në jetë çdo gjë duhet përballuar,*

*Veten tënde beso*

*Në jetë çdo gjë duhet sfiduar.*

*Ti je e fortë më beso*

*Askush nuk rringrihet nëse s'ka durim,*

*Nga vetvetja ti mëso*

*Në ferr më beso se nuk ka shpëtim.*

*Jeta është me shumë ngjyra*

*Të sfidon të rrëzon,*

*Njerëzit janë të gjithë me dy fytyra*

*Por çdo herë gjëra të rreja të mëson.*

*Ti mundesh unë e di*

*Mos i humb kurrë shpresat,*

*Edhe pse për ty nuk ka lumturi*

*Në jetë ka edhe shumë pengesa.*

## *Motër*

*Zihem shpesh dhe hidhërohemi  
Por jemi ata që dashurohemi,  
Qajmë, mërzitemi ndonjëherë  
Por të premtoj do të më qesh afër çdo herë.*

*Qeshim, lozim bashkë  
Si kur ty asnjëherë nuk kam me dashtë,  
Ti je ajo që dhuron ngrohtësi  
Edhe kur jam në vështirësi.*

*Motra ime gjaku im  
Unë do të kem gjithmonë në shpirtin tim,  
S'do të harroj asnjëherë  
E di pa ty s'mund të kaloj ndonjëherë.*

*Jemi rritur me dashuri  
Por ti në zemrën time je thjesht lumturi,  
S'mundet të paramendoj një jetë pa ty  
Motër të dëshiroj çdo herë lumturi.*

## *Mjaft, të lutem mjaft*

*Kam zemër nuk kam më fat,  
Pse më humbe buzëqeshjen kur të desha,  
Pse nuk më prite kur unë doja të vija,  
Kur ëndrrat ishin të mëdha dhe zemra vuante,  
Vetëm atë zjarr në zemrën askush nuk e shuante.*

*Unë të adhurova  
Adhurova dashninë tënde,  
Adhurova sytë, adhurova buzët,  
Por vetëm një gjë nuk meritova,  
Dashurinë që kisha me duart e mija e shkatërrova!*

## *Në baltë*

*U zhyta thellë më thellë,  
U dogja zjarr në zjarr,  
Unë durova dhimbje çdo herë,  
Me sy lumturinë ta ktheva për së mbarë.*

*U lakmova në çdo lule,  
Asnjëra aromë s'ishite siç e doja,  
Ti me mua pse nuk u mburre,  
Ndonjëherë t'ia dal thosha.*

*Lotin nuk e ndala,  
Buzëqeshjen e riktheva,  
Por ty zemrën ta fala,  
Në sytë e mi shkëlqeva.*

## *Në krahët e dashurisë*

*Sa e bukur apo jo  
Të duash e të të doja,  
Sytë t'i shkëlqejnë pas teje,  
Sa e bukur kur të dashuron  
A thua vallë jeta më ndryshon,  
Gurgullimat e ujit nuk ndalojnë  
Zogëza për dashurinë këndojnë.*

*Sa mirë të flesh duke ëndërruar  
Dikush për ty qëndron  
Tërë natën zgjuar,  
Oj zemër sa fortë po rreh  
Në krahët e dashurisë ti po fle,  
Buzëqesh çdo natë kur të mendoj  
Ndonjëherë edhe veten harroj,  
Më beso se jam e lumtur kur të shikoj  
Ah!  
Kjo dashuria më verboi.*

*Jam ulur po shkruaj  
Në vargje librat i krijtoj,  
Sa bukur veten më shumë e dua  
Me fat jam që të kam  
Duart e mia dridhen kur të mendoj,  
Shpirtin tim vetëm ti po e mbanë  
Në krahët e dashurisë  
Kjo vajzë fluturoi.*

## *Ne*

*Ku jemi ne,  
Pse nuk më kuptove asnjëherë,  
Pse nuk më kërkove siç të kërkova,  
Pse nuk më adhurove,  
Çfarë deshe nga unë,  
Por më lë të vetme,  
E dhimbjet mua mi shtove.*

## *Një diçkaje i vjen fundi*

*Ditët kalojnë stinët mbarojnë  
E njerëzit sërish jetën vazhdojnë,  
E ata me atë forcë rringriten dhe jetojnë.*

*Një diçkaje i vjen fundi  
Edhe në qoftë se e ke dhënë tërë mundin,  
Një ditë as dielli nuk lind  
As nëna fëmijët e saj nuk mund t'i bind.*

*Një ditë as dashuria nuk ka për qenë e bukur  
Një ditë njerëzit do mbyllën gjithmonë të strukur,  
Një diçka i vjen fundi një ditë  
Duhesh me qen i lumtur me atë që e ke për ditë.*

*Sërish jeton dhe thua jeta po vazhdon,  
Është e vështirë por sërish ke shpresë  
Sërish aktron sikur në gjithçka ke besë.*



## *Një ditë*

*Një ditë do arrij*

*Një ditë do bëhem ajo*

*Që ëndrrën realitet do e bëj.*

*Një ditë do ia dal*

*Një ditë shumë njerëz do fal,*

*Një ditë do punoj*

*Shumë të ardhura do siguroj.*

*Një ditë do premtoj*

*Më shumë në jetë do dashuroj,*

*Një ditë do të them faleminderit*

*Çdo herë do të kem nderin.*

*Një ditë do bërtas*

*Për drejtësitë e mija do të flas,*

*Një ditë do të jem ajo që se pret askush*

*Por do luftoj për atë ditë deri sa të bëhem prush.*

## *Një shkrepës*

*Në këtë natë të bukur  
Yjet në qiell po shkëlqejnë,  
E strukur nën një batanije  
Sytë e mi hiç nën po e sodisin.*

*Ndeza një shkrepës dhe po mendoja  
Me këtë lumturi dashurinë po kërkoja,  
Ajo shkrepës më dha pak ngrohtësi  
Mos mendoja më për vetmi.*

## *Një zemër në një botë*

*Ajo zemër ishte vetëm  
Ajo zemër nuk kishte tjetër,  
Një zemër në një botë  
Ajo ishte shumë e fortë.*

*U lodh nga padrejtësia  
Atë zemër e shtypën nga vetja,  
Një zemër në një botë  
Atë zemër nuk e mbajti kjo tokë.*

## *Njeriu në fund do mbetet njeri*

*Çdo kush mundohet të jetë më i mirë  
Çdo kush mundohet të gjej lumturinë,  
Por çdo kush ndonjëherë veten e gënjen  
Sepse brenda vetes të vërtetën nuk e gjen.*

*Njeriu në fund mbetet njeri  
Nuk ndryshon aspak as në dashuri,  
Ai nuk mund të bëhet siç ti e do  
Por ai jeton jetën vet si e dëshiron.*

*Nuk mund të nxjerr shpirtin e vet për ty  
Sado që të mundohet ai sërish është njeri,  
Ai jeton jetën si e ka vendosur vetë  
Pa marr parasysh për ty a është e drejtë.*

*Njeriu përballë jetës mbetet gjithmonë nxënës.*

*Ti rritesh kupton, mëson  
Shumë sakrifica në jetë kalon,  
Por ti një gjë mos e harro  
Nxënës përpara jetës do ngelesh gjithnjë.*

*Bëhesh e pjekur pendohesh për gabimet e tua  
Por sërish ti thua jetën do ta dua,  
Përballë jetës nuk ke rrëndësi  
Sado që të mundohesh të falësh lumturi.*

*Ajo sot të rrëzon  
Nesër në qiellin e shatë të dërgon,  
Eh... gjithmonë mëson e mëson  
Edhe ashtu koha kalon.*

*Mos thuaj nuk e kam pas jetën kurrë të bukur  
Ka më keq dhe atë në vetvete të strukur,  
Njeriu përballë jetës mbetet nxënës gjithmonë  
Edhe atë që e ha, ti e harron....*

## *Elegji për nënën*

*Sa net isha pa gjumë  
Sa ditë qaja për ty,  
Oj nënë e varfër po shkruaj  
Sepse pa ty nuk kam lumturi.  
Flokët e gjata mi kreh  
Ah moj nënë u largove shumë e rre,  
Dëshiroj edhe me tej të fle me ty  
Dëshiroj të të tregoj një mërzi.  
Kjo natë e errët  
Këto ditë pa diell,  
Këto mjegulla  
Ky shtu i zymtë  
Oj mëmë unë pa ty po ndjej mërzi.  
Më le të vogël, thjeshtë u largove  
Me vete dashurinë time e more,  
Sa vështirë të mos flesh e qetë  
Pse moj mami më le mua vetë.  
Dielli reze nuk lëshon  
Kurse ti, larg çdo natë më qëndron,  
Sa më ka marr malli me ti pa sytë  
Unë nuk e dija që ti kishje me ik,  
Oj Mëmë e varfër po të shkruaj  
Edhe këtë vit pa ty e shuaj.  
Mbeta vetë, pa ty  
Gabime plot  
Babi më duket se nuk më sheh në sy,  
Sa frikë të jesh pa prind  
Oj Mami im nuk po rrihet pa ty,  
Sa do doja të të kem  
Të gjithë bashkë një zemër të kemi  
E varfër po të shkruaj  
Fotografitë gjithmonë do ti rruaj,*

*Më shikoi jeta e shqetësuar  
Me probleme e të bërtitura,  
Asnjëherë këtë se prita,  
Desha pak lumturi  
Familjarisht ta festojmë Vitin e Ri.  
Sa dhimbe po ndjej sot  
As nuk mundem me nxjerr lot,  
Askujt nuk i interesoj  
Mundohem gabime të mos bëj,  
Jam e re gënjehem lehtë  
I humbas njerëzit që i dua me të vërtetë,  
Jeta më sprovoi  
Nga të tjerët të mësoj,  
U shtypa u zhgënjeva  
Por pa ty oj mëmë vetëm u theva...*

## *Padrejtësitë*

*Kur dikush të zhgënjën  
Besim tek vetja ti nuk e vëren,  
Kur të thotë se kam nevojë për ty  
Mos be shumë, bota ka padrejtësi.*

*Duaj aq sa duhet  
Me zjarrin asnjëherë nuk luhet,  
Beso aq sa të mundësohet  
Mos beso që të fundosesh,  
Jeta tkurret në përpjesëtim me kurajën tënde  
Por ti e di, padrejtësitë të lënë pa mëndje.*



## *Para pasqyrës*

*Sa herë del para pasqyrës  
E shikon vetveten,  
Ia tregon ndonjëherë dëshirën  
Apo shikon të pavërtetën.*

*A e pyet veten se kush je  
Çfarë ëndrre e çfarë qëllimi ke,  
Para pasqyrës nuk shikohet vetëm bukuria  
Mendoj se duhet të shihet brendësia.*

*Kur gjykon dikë  
A mendon se ka ndjenja  
Dhe ajo dashuron,  
E gjykon për bukuri  
Apo se nuk e pëlqen për shoqëri.*

*Hë më thuaj a e pyet veten se kush je  
Për të ofenduar zemër ti ke,  
Para pasqyrë me çfarë fytyre po del  
Kur dikë bën që lotët në syrit t'i ngelin.*

## *Pasardhëse e lumturisë*

*Shiko sa bukur të jetosh  
Shiko se dielli sërish ka lindur,  
Më besoni asnjëherë në jetë s'do të jetë bosh  
Hëna sërish do të del, jam e bindur.*

*Pasardhëse e lumturisë jam  
Të gjithë botën në shpirt do ta mbaj,  
Vuajtje në jetë më nuk kam  
Më lotët nuk do më shkojnë vajë.*

*Jam ajo që e dua lumturinë  
Lumturia vjen nëse e kërkon,  
Nuk e lë anash as dashurinë  
Vetëm me shpirt kur dashuron.*

## *Pavarësia*

*Sa lot sa dhimbje kemi pasur  
Me gjak e me shpirt dhimbje kemi hasur,  
Oj Kosovë moj e shkrretë  
Dikush për ty dha edhe jetë.  
U derdh gjak për ty  
Ah moj e mjera pavarësi,  
Sa nëna shqiptare vranë  
Ushqim në sofër nuk i lan.  
Ah sa vëllezër le pa motra  
Si të mban ty edhe toka,  
Vranë njerëz të pa faj  
Lanë fëmijë me lotët  
17 shkurti nuk u harrua.  
Me flamuq të valëvitur në duar  
U derdh gjak për ty oj e shkrretë pavarësi,  
Por ti nuk je  
Oj e dashura nënë  
Dielli dhe qielli më nuk u panë.  
Kujt ti qaj, kujt ti flas  
Shqipen në zemër gjithmonë do ta kem,  
Ah moj Kosovë pa fjalë na le  
Ne shqiptarët afër na ke,  
Ku do që shkoj do të mendoj  
Asnjëherë pavarësinë nuk do e harroj.*

## *Për ata*

*Sikur dhelpra dikur moti  
Thoshte rrushi është i tharët  
Nuk është për racion,  
Kur të njëjtin e shijoi  
Ndëroi fjalët për gjithmonë.*

*Edhe ju o të mjerë  
Nëse diçka nuk dini  
Mos flakni tej gjithçka,  
Pyesni ka njerëz që iu ndihmojnë  
Nuk i dihet nesër bëhesh mjeshtër  
I asaj që edhe në ëndërr se kujton.*

## *Për thesarin tim ...*

*Të ndjeja, me të vërtetë të ndjeja,  
O thesar i im, me plot shkëlqim,  
Çdo gjë në sytë e tu e vëreja  
Jeta ime pa ty s'ka kuptim.*

*Yjet e shndrisnin me plotë vizëllim  
Unë të dashuroja aq sa malet,  
Ti në jetë asnjëher nuk më dhe pikëllim  
Dëshia që zemra të mos më ndalet.*

*Thesar, o thesar  
Ti je i vetmi shpëtim,  
A thua vallë do të jem nuse me fustan të bardhë  
Me ty asnjëher nuk do kisha dështim!*

## *Përgjithmonë*

*Edhe atëherë kur vjedhurazi më shikon  
Më do, këtë nuk e mohon.*

*Edhe kur shtiresë se më urren  
E di që më dashuron  
Por se thua, pse nguron.*

*Kur të tjerët shpifin për ne  
E dua thua ju,  
Mbyllja gojën sa herë që dëshiron.*

*Edhe atëherë kur ti hidhërohesh  
Të dua, këtë mos e harro,  
Fati e deshi s'kemi çka ti bësh.*

*Të them gjithnjë të dua  
Andaj pres që sa më shpejt  
Të me thuash të dua përgjithmonë.*

## *Poezia*

*Poezi unë po shkruaj  
Në vargje poema po i realizoj,  
Mos më thoni mos e duaj  
Ëndrrën time e bëra realitet,  
Jo më të ëndërroj në këtë jetë.*

*Poezi me plot kuptim  
Ishite e ardhmja që më dha inspirim,  
Kalojmë kohë me stilograf  
Të tregojmë dhe ne që kemi një art.*

## *Rilind dielli im*

*Kur dielli i rihap rrezet e tij  
Mua më fal shumë dashuri,  
Kur hëna është e plot  
Mendimet si ndaloj dot.*

*Inspirohem nga melodia  
Çfarë më duhet dashuria,  
Kur kam afër një familje  
Një diell rikthehej në rilindje.*

*Afër babait unë kur jam  
Këshillat gjithmonë në zemër kam,  
Sërish dielli më rilind  
Një dashuri tjetër mua më bind.*



## *Sa të desha*

*A të kujtohet sa të desha  
Sa mërzi e pikëllim ndjeva,  
Kur ishe ti këtu, unë zbehesha  
Por çdo gjë tash e vëreja.*

*Ah moj hënë moj e mjerë  
E shikojnë je gjysmë e s'je e plotë,  
Ti mua po më bën helm e vrer  
Sepse ti njerëzit si bashkë dot.*

*Rigat e shiut në dritare  
Pse gjithmonë aq rëndë,  
Ti dashuri moj mëkatare  
Nuk zë më asnjë vend.*

*Sa të desha, sa të desha  
Kurë në jetë s'të harrova,  
Ti moj dashuri më bëre sikur vreshtat  
Ah dashuri unë gjithmonë të kujtova...!*

## *Sfidë jete*

*Kështu e ka kjo botë,  
Me sfida gjithnjë të jetosh,  
E mbi to ardhmëri të ndërtosh.*

*Sa të pa shpirt bëhen njerëzia  
Shpikën gjëra të pa bëra,  
Të mendojnë e ofendojnë  
Qëllimet e tyre t'i realizojnë.*

*Nuk do ndalem kur në jetë  
Të shkruaj e të krijoj,  
Libra tjerë të botoj  
Ardhmëri të trasoj.*

## *Shoqëria*

*Shoqëria e vërtetë  
Të ndihmon mirë dhe drejtë,  
Në disa raste të mëson  
Aq sa të do, të edukon.*

*Asnjëherë nuk të do të keqen  
Edhe nëse në të kaluarën mbeten,  
Gjithmonë duan afër të qëndrojnë  
Janë ata që ëndrrat na bëjnë ti realizojmë.*

*Një shoqe kur të flet për të mirë  
Mos u bëj xheloze ndoshta ajo e di më mirë,  
Të japin kurajë të vazhdosësh  
Sfidat në jetë ti tejkalosh...*

## *Shpresë*

*Çdo ëndërr sy mbyllur fillon  
Mendoja se për mua s'ka diell të lindur,  
Shpresat me sa duket u shuan  
Mendoja se njerëzit më pak më duan.*

*Çdo natë qëndroja duke menduar  
Thosha se vetëm unë jam e vetmuar,  
Po bëja durim se Zotin e kisha  
Shpresë tek ai kisha sepse vetëm ai mua më fal.*

*Nuk u dorëzova qëndrova e fortë  
Përsëri dashurin e njerëzve se ndalja dot,  
Luftova çdo fjalë të pakuptim  
Dhe në fund fitova një çmim.*

*Shpresë kisha gjithmonë  
Dhe dëshiroja ta takoja,  
Më mirë vonë se sa kurrë  
Shpresën time për gjithmonë.*

## *Shqipërisë*

*Pse moj Shqipëri pa zemër na le  
A nuk të erdhi keq që derdhëm gjak për atdhe,  
Ku janë ata trima, pse vdiqën aq të rinj  
Ty po të flas oj e mjera Shqipëri,  
U derdh gjak për ty.  
Por ti nuk je, o e shkreta Shqipëri,  
Sa njerëz u vranë  
Për ty oj e dashura nënë,  
Të deshëm, lamë kockën pas teje,  
Po ti moj Shqipëri asgjë nuk vëreje.  
Flamurin në dorë e mbanim  
Nga vendi jonë asnjëherë nuk ju ndanim,  
Marigona e qëndisi me dy duar  
Këtë flamurë që sot është duke vluar.  
Atdheun e mësuam duke të dashuruar  
Oj Nënë Shqipëri  
E di për sa lot shakqatave u bërë ti,  
Oj e shkreta në male të largëta  
E di sa poezi janë shkruar me vargje të arta,  
Sa të deshëm sa të duam  
Ne kur moj Shqipëri s'të harruam.*

## *Shqiptare jam*

*Ku do që shkoj  
Ku do që flas,  
Gjuhën time nuk do ta harroj  
Gjuhën shqipe gjithmonë do ta flas.*

*Kush do që më rrethon  
Çfarë do që të jetë,  
Shqipërinë zemra ime e dashuron  
Shqiptare jam me të vërtet.*

*Është derdh gjak  
Është derdh lot,  
Pak mëshirë të këni o njerëz pak,  
Dikush vdiq në luftë të mbijetoj s'arriti dot.*

*Shqiptare jam  
Në zemër kërenarinë e kam,  
Shqip po flas  
Shqip po iu them,  
Ngjyrën e kuqe në shpirt do ta kem.*

*Do luftoj do gërmoj  
Gjuhën time jo kurrë se harroj,  
Do luftoj me mish e shpirt  
Vendit tim do ti fal gjithmonë dritë.*

*Do të përçahem  
Nga vendi im asnjëherë nuk do të ndahem,  
Do lëndohem do hidhërohem  
Një ditë nga ky popull do të lirohem.*

## *Stinët e harruara*

*Kur njerëzit dashurojnë  
Veten e tyre e harrojnë,  
E kështu stinën kalojnë  
Kështu të dashuruar  
Një ditë jeta përfundon.*

*Kur fëmijët rriten  
Stinët harrohen,  
Iqin edhe ata bashkë me vitet  
Familjet më së shumti dashurohen.*

*Kur shuhen palumturit  
Njerëzit rikthejnë dashurinë,  
Stinët iqin bëhem të harruara,  
Vështirësitë, dimri dhe mjegullat  
Ngelën në të qaluarën.*

## *Suksesi*

*Më quajtet të dobët  
Sot nuk arrini të më njihini,  
Punoja, gjithmonë punoja,  
Ujin askujt nuk ia turbulloja,  
Punën time shikoja,  
Ëndrrën time realizoja.*

*Sot nuk doni të më njihini,  
Nuk di nga xhelozia e këni,  
Apo vërtetë e tillë jam,  
Ose pamje të tillë kam.*

*Punova, mësova,  
Suksesi nuk vonoi,  
Në jetë gjithmonë fati me ndihmoi,  
E tani televizione do më shihni,  
Nuk besoj se edhe ju do më xhelozoni.*

*Nuk kanë besuar  
Më kanë përbuz përbuz,  
Por të gjithë i kam pranuar  
Çdo herë isha e duruar .*

*Kam qarë kam qesh  
Ëndrrën time realitet e bëj,  
Askënd nuk e poshtëroj  
Familjen, miqtë e dashamirët  
Gjithmonë i befasojë.*



## *Testamenti i jetës*

*Ndonjëherë mendon gjatë  
Nga njerëzit e lodhur çdo natë,  
Jeta të kundërvihet majtas e djathtas  
Nuk dëshiron dritë të shikosh as të dalësh jashtë.*

*Ti mundohesh për mësuar diçka  
Kurse një fjalë e vogël mbyttë shumëçka,  
Ti sërish thuash se do ja dalë  
Por një gurë i rëndomtë të del përballë.*

*Ti sërish çohesh dhe rringrihesh  
Thashethemet e bëjnë jetën të vetëvritesh,  
Njëri shpik diçka, tjetri manipulon  
A thua vallë jeta kështu qalon.*

*Ti mundohesh të jesh e zonja e vetes  
E ti sërish i akuzon sfidat e jetës,  
Ti po thua se po qalon  
Po mban shpresë për një jetë të rre,  
Por duke u stresuar jeta më shumë të mundon  
Të rinjtë shtrohen në varreza,  
Dhe përmbi ta të mbuluar me dhe.*

*Kërkon lumturi por s'mund ta gjesh  
Vetëm të këqijat ti di vërsh,  
Dikush të shan të tall  
Por ti thua edhe kjo do qalon.*

*Bëhesh i fortë nuk dorëzohesh  
Mundohesh më shumë të mos anqohesh,  
Gabon lehtë, ke frikë  
Mundohesh të rruhesh nga njerëzit e frikë.*

## *Ti je e fortë*

*Pse po vuan*

*Ti mundësh të ia dalësh,*

*Nuk duhet të tjerët të të duan*

*Më beso ti mund edhe veten të falësh.*

*Ti je e fortë e bukur*

*Pse duhet me u mërzit ke jetë të gjatë,*

*Mos qëndro në stres dhe e strukur*

*Mbi supet tua do kesh shumë barë.*

*Pse po derdh lot kur nuk i meriton*

*Për çfarë arsye duhet me i dëgjuar tjerët,*

*Vëre dorën në zemër mendo se edhe dikush ty të donë*

*Ti dëgjoje zemrën tënde, veten tënde.*

*Do qalosh dhe do qalosh shumë sfida*

*Por jo duke mos u rringritur,*

*Jeta nuk është e bardhë si drita*

*Dhe jo duke qenë çdo herë e venitur.*

## *Tinguj përtej horizontit*

*Isha afër liqenit duke menduar  
Pas të ardhmes isha dashuruar,  
Ndoshita kisha gabime para saj  
Përtej horizontit shikoja  
E lotët mbi qepalla nuk mund t'i ndaloja.*

*Disa tinguj i dëgjova  
Në afërsi të liqenit poezi krijoja,  
Ndoshita pak u emocionova  
Dashurinë ardhmërisë ia dedikova.*

*U bë errësirë unë sërish aty  
Eh sikur të ndalej koha sepse kisha lumturi,  
Kështu vazhdova të jetoj  
Veten time më me askënd mos ta krahasoj.*

## *Trëndafili*

*Ah mor trëndafil  
Me petale të kuq si zjarri  
A thua ti mua më fale,  
Unë po përjetoj  
Ditët më të këqja se vari.*

*Sa të jem gjallë do të kujtoj  
Asnjëherë aromën tënde nuk do e harroj,  
Trëndafil i vyshkur të kësaj rënë ajo ngjyrë  
Sa shumë more trëndafil qenke mpirë.*

## *Trëndafili i vyshkur*

*Ai trëndafil nuk ka më aromë  
Ajo vajzë nuk del nga ajo dhomë,  
Çfarë pati, çfarë kishte  
Askush në krahë me të nuk ishte.*

*Ai trëndafil që nuk ka më erë  
Për atë vajzë a mendoni*

*Se erdhi e njëjta verë,  
I ranë petalet nga pa urtësia  
Atë vajzë e zunë edhe perit.*

*Nuk çeli më aspak petale  
Ajo vajzë më nuk pati*

*Të njëjtën buzëqeshje,  
Ajo vajzë nuk ishte më  
E mbyllur më vetvete.*

## *Unë do ja dal*

*Thuaj ndonjëherë*

*Unë do ia dal,*

*Mos e bëj veten me lot çdo herë*

*Vetes time shpresë do ti fal.*

*Thuaj unë mundem e fortë të jem*

*Jeta nuk kalon vetëm me një fatkeqësi,*

*Sakrificat e jetës do mundem ti përballoj*

*Do të shitypin, do qesh edhe vështirësi.*

*Mos thuaj se s'jam mirë,*

*Mos u trego se je e lënduar,*

*Më beso do ta marrin për dobësi,*

*Buzëqesh qëndro në këmbët e tua*

*Bën sikur je dashuruar.*

## Unë

*U largova nga njerëzit që nuk më deshën,  
U largova nga ata që nuk më mësuan të drejtën,  
U largova nga ata që më urryen,  
U largova nga ata që më zhgënjyen.*

*Un nuk isha kjo,  
Isha ajo që mërzhitesha kur dikush bënte shaka në diçka  
Isha ajo që nuk mund të duroja diçka që kalon kufirin e tij...  
Jo sepse nuk e doja atë person por sepse  
Unë isha ashtu por sot është krejtësisht e kundërta.*

*Edi, ndoshta edhe disa nuk kanë besim tek unë  
Por nuk jam ajo që e gënjen dikë pa arsye,  
Nuk jam ajo që isha dhe që mërzhitem shpejt  
As nuk jam ajo që qaj sa herë që dikush më kritikon,  
Jam ajo që duroj, jam ajo që ëndrrat e mija  
I kam vendosur të parat pavarësisht çfarë mendojnë të tjerët.*

*Un nuk jetoj për të tjerët as nuk flas për të tjerët  
Po mundohem të kritikoj veten,  
Po mundohem të flas me vetveten,  
Po mundohem të bëj krenare familjen time,  
Dhe jo të mendojnë se unë jam në rrugë që nuk ka rikthim.*

*Unë nuk jam në atë rrugë unë thjesht jam një adoleshente  
Që dua ta shijoj jetën por jo me gabime,  
Thjeshtë unë kam nevojë kur të provoj të bëj diçka  
Dikush të më thotë "Ndalo se gabim je"  
Unë jam në atë moshë që kam nevojë për njerëz të drejtë(familja).  
Kjo jam unë për ata që nuk më kanë njohur.*

*Unë thjesht dua vetes t'ia plotësoj ëndrrat e mija  
Dhe ti realizoj dëshirat që zemra ime kërkon,  
Unë nuk kam jetuar për të tjerët as nuk jetoj,  
Jetoj për veten time asgjë më shumë....*



## *Vajzë*

*Kam të drejt të punoj  
Kam të drejt të mësoj,  
Kam të drejtë dhe të dua  
E drejta është edhe për mua.*

*Jam ajo që nuk dorëzohem  
Për çdo gjë unë nuk vonohem,  
Jam ajo që kuptoj  
Talentin tim e shfrytëzoj.*

*S'je askush për të më gjykuar  
Sfidat në jetë gjithmonë i kam përballuar,  
Jam femër  
Nuk duhet të lëndosh këtë emër.*

## *Vendi im*

*Jetoj larg nga qyteti  
Atje nuk më rrethon deti,  
Jetoj në zemër të maleve  
Atje ku nuk kam aspak halle.*

*Atje ku papastërti s'mungon  
Atje ku secili të dëshiron,  
Është pak larg nga qyteti  
Por kishim shumë dashuri,  
Atje nuk ka interes  
Atje besa është besë.*

*Ai është fshati më i bukur  
Unë atje jam e lumturi,  
Merreshim me kuqësi  
Sa bukur të jetosh edhe me atë dituri.*

*U shqillova në atë fshat  
Kam lozur e vrapuar në çdo livadh,  
Udhëtova mal më mal  
Me të vërtetë atje nuk kam pasur aspak halle.*

## *Vetë i shërova plagët*

*Më premtuan  
Më thanë të dua,  
Por më braktisën  
Më lanë të pa shpresë  
Ata më nxitën më dhanë shpresë.*

*Kafshët, pyjet, malet më lanë  
Sërish vetë i shërova plagët,  
Nga dhimbja sytë më dritë nuk më panë  
Isha e humbur në detin, në ata dallgët.*

*Isha vetëm me veten time  
Ëndrra plot por u shuan,  
Isha duke i bërë presion zemrës sime  
Për ata që më lënduan..*

## *Violina*

*Sa e adhuroj një violinë  
Që të prek në shpirt ajo melodi,  
E dashuroj atë melodi  
Kur bëhet fjalë për dashuri.*

*Është e bukur është mahnitëse  
Të bën të qash por shumë e dhimbshme,  
Ajo melodi më bën të këm motiv  
Edhe poezi kur shkruaj unë kënohem.*

## *Viti i 2022-të*

*Me plotë sakrificë  
Edhe ky vit kaloi,  
Lot, mërzi ditë për ditë  
E karakterizoi këtë vit.*

*Vdekje dhimbje çdo ditë  
Hare e gëzim më pak,  
Shpresoj të ndryshoj ky vit  
Nga viti që lëmë pas.*

*Të jetë një vit i lumtur  
Ky i radhës që po vinë,  
Të mos këtë njerëz të strukur  
Të jetë një vit plot dashuri,  
Familjet mos të kem aspak mërzi.*

*Viti i 2022-të mos të kthehet  
Dashuria e njerëzve vetëm të ndjehet,  
Të jenë të lumtur e të buzëqeshur  
Mos të qëndrojnë të strukur e të heshtur.*

## *Vlerat e nënës*

*Çdo ditë e çdo natë ajo mendon  
Për fëmijët e saj veten e sakrificon,  
Qanë mërzitet si do ti shkolloj  
A thua vallë fjalën e saj e do dëgjojnë.*

*A nuk mendoni pak për atë grua  
Ju a vetëm një të huaj i thoni “të dua”,  
Pse nuk flet me atë e nuk i tregon një hall  
Pse për nënën tënde nuk ke aspak mall.*

*Si nuk të intereson kur ajo të mëson  
Pse e ul koka në rrejetet sociale qëndron,  
Pse vlerën e saj nuk e di askush  
Ajo e shkrete plot mëri dhe dhimbje është mbush.*

*Veshmbathjet e tua që po i mban  
Ushqimin kur kthehesh nga shkollla nga kush e po han,  
Dashurin e saj një mashkull nuk ta jep  
Vetëm ajo qëndron zgjuar dhe nuk fle e qetë.*

*Kurse ti farë bën  
Aqoma më shumë pas shpine e lëndon,  
Dikush nuk e ka e dëshiron  
Por ai që e ka vetëm e nënvlerëson.*

*Mendoni pak mos të ishe nëna  
As rreze drite nuk do lëshonte hëna,  
Do zgjohesh në mëngjes do pastroje ti  
Më besoni pa nënë ka shumë vështirësi.*

## *Yjet dëshmitar*

*Një yll i bukur lartë në qiell  
Xixëllon aq bukur ndriçon,  
Si rreze e dritës kurr lënd diell  
A thua vallë mua më dashuron.*

*Aq i shndritshëm aq i veçantë  
Është plot kështu çdo natë,  
Ai yll i bukur zemrën po më përçan  
A thua edhe unë kam pak fat.*

*Perëndia e krijoj  
Atë yll të bukur e bëri të ndriçoj,  
Në errësirën në këtë natë  
Ky yll më bëri të ndihem më me fat.*

## *Zemër*

*E di që ti po duron,  
Zemër, e di se tënden ti kërkon.*

*E di se ti po qanë,  
E kërkon atë që do ta keshi pranë.*

*E di se ti je e fortë,  
Përballimet dhe sfidat nuk i ndalon dot.*

*Mundohesh të ia dalësh por zhgënjehesh,  
Ah moj e vogla zemër ti shumë po vërehesh.*

*E vogël por ka ndjenja,  
E vogël po kështu është zemra.*



## *Kurbeti*

*Sa i vështirë kur dikush largohet  
Kurse dikush në sytë ka vetëm lot,  
Sa e rëndë kur nuk mund ta shikosh  
Vetëm zërin në celular mund t'ia dëgjosh.*

*Kur zemra të shtrëngon fortë  
Kur lotin nuk mund ta ndalosh dot,  
Kur mendon tërë natën se sa larg ka udhëtuar  
Kur nga larg njerëzit jetojnë të dashuruar,  
Ah sa e rëndë të jesh në tunel e të mos bësh zë  
Nuk mundem, nuk duroj dot më.*

*Ah sa e vështirë kur të lëshon dorën  
Ah more kurbet na mbyte për së gjalli,  
O zot çfarë tmerri është ky, çfarë halli  
Të të mungoj është e vështirë,  
Por më e rëndë është kur të jep të fundit lamtumirë.*

## *Mes poezive të poetes Elisa Iljazi*

Të lexosh poezi të cilat sikur pikturohen piktura më vete dhe, marrin ngjyrë sipas temave të trajtuara, duke u motivuar nga ndodhitë e jetës e në veçanti duke i personifikuar figurat si nënë e motër e lla e shumë figura të tjera, që librit “Çelësi i lumturisë”, i japin një natyrë plot peizazhe e drama jete, të cilat në zemrën e poetes Elisa Iljazi kanë mbetur herë si dhimbje e jerm si lumturi jete, që si zakonisht e rrethon çdo ambient familjarë e shoqërore në trevat tona.

Si poezi të këtitilla, lirshëm mund të themi se poetesha në fjalë shfaq pjekurinë e saj qarshi dukurive dhe fenomeneve që na ndjekin dhe që na lënë plagë të pashlyeshme në jetë, në veçanti padrejtësitë sociale, dallimet mes gjinive e, mbi të gjitha kurbeti si plagë më e theksuar, që për poeteshën është dhimbje e dyfishtë dhe atë duke u nisur nga skamja si detyrim e deri të harresa si vdekje për rininë tonë e cila në kërkim të mirëqenies ekonomike ballafaqohet me asimilim dhe, natyra të ndryshme jetike, që për mbarë shoqërinë tonë mbeten plagë e dhimbje si gjithmonë ndër shekuj.

Fundja, lirshëm mund të them se me këto poezi poetesha Elisa Iljazi, ja ka arritur që ta jep mesazhin e saj për shoqërinë tonë dhe, besoj se po të lexohen poezitë me syrin e realitetit shoqërorë mes nesh do e kuptomë se secila poezi e librit “Çelësi i jetës”, vërtete është çelës për dyert e jetës sonë se ku duhet të hyjnë, që të jemi fitimtarë e jo humbës nëpër udhët e jetës, që duhet t’i jetojmë, për t’ia shtruar lumturinë ardhmërisë së shoqërisë sonë, e cila nesër duhet të duket e lumtur e jo më dhimbjet që i cekëm më lartë.

Uroj, që poetesha Elisa Iljazi të vazhdoj me shkrimet e saja, sepse na premtan se mund të jetë nesër një penë e skalitur në piramidën e poezisë shqipe.

**Behare Neziri**

*Përmbajtja:*

<i>A nuk jam një grua.....</i>	<i>5</i>
<i>A thua vallë.....</i>	<i>6</i>
<i>Sikur jeta të ishte poezi.....</i>	<i>7</i>
<i>Ajo duron .....</i>	<i>8</i>
<i>Asgjë rastësisht.....</i>	<i>9</i>
<i>Aty ku s'jam unë .....</i>	<i>10</i>
<i>Besoj.....</i>	<i>11</i>
<i>Biri im .....</i>	<i>12</i>
<i>Borxhi.....</i>	<i>13</i>
<i>Bukuria .....</i>	<i>14</i>
<i>Dashuria jonë.....</i>	<i>15</i>
<i>Dikur.....</i>	<i>16</i>
<i>Ditë e re.....</i>	<i>17</i>
<i>Do të kërkoj.....</i>	<i>18</i>
<i>Dritë mbi plagë.....</i>	<i>19</i>
<i>E di fatin tim .....</i>	<i>20</i>
<i>E di.....</i>	<i>21</i>
<i>E fortë si gurë.....</i>	<i>22</i>
<i>E kudo ndodhura .....</i>	<i>23</i>
<i>E padrejtë.....</i>	<i>24</i>
<i>.....</i>	<i>25</i>
<i>Ëndërroj .....</i>	<i>27</i>
<i>Është bukur të jetosh .....</i>	<i>28</i>
<i>Gjithmonë ka një shpresë.....</i>	<i>29</i>

<i>Hënë ndriço</i> .....	31
<i>Herë këndej e andej</i> .....	32
<i>Heshtën</i> .....	33
<i>Jam vetëm</i> .....	34
<i>Kaloi</i> .....	35
<i>Kanarina në dritare</i> .....	36
<i>Kjo botë</i> .....	37
<i>Kjo poezi</i> .....	38
<i>Ku janë</i> .....	39
<i>Kurbeti</i> .....	40
<i>Lamtumir atdheu im</i> .....	41
<i>Lamtumirë</i> .....	42
<i>Lulëkuqja</i> .....	43
<i>7 Marsi</i> .....	44
<i>Urime 8 Marsi Nënë</i> .....	45
<i>Mallë</i> .....	46
<i>Me plot sfida</i> .....	47
<i>Mes dy botëve</i> .....	48
<i>Mos u mërzit</i> .....	49
<i>Motër</i> .....	50
<i>Mjaft, të lutem mjaft</i> .....	51
<i>Në baltë</i> .....	52
<i>Në krahët e dashurisë</i> .....	53
<i>Ne</i> .....	54
<i>Një diçkaje i vjen fundi</i> .....	55

<i>Një ditë.....</i>	56
<i>Një shkrepës .....</i>	57
<i>Një zemër në një botë .....</i>	58
<i>Njeriu në fund do mbetet njeri .....</i>	59
<i>Njeriu përballë jetës mbetet gjithmonë nxënës.....</i>	60
<i>Elegji për nënën.....</i>	61
<i>Padrejtësitë.....</i>	63
<i>Para pasqyrës .....</i>	64
<i>Pasardhëse e lumturisë .....</i>	65
<i>Pavarësia.....</i>	66
<i>Për ata.....</i>	67
<i>Për thesarin tim .....</i>	68
<i>Përgjithmonë .....</i>	69
<i>Poezia.....</i>	70
<i>Rilind dielli im.....</i>	71
<i>Sa të desha.....</i>	72
<i>Sfidë jete.....</i>	73
<i>Shoqëria.....</i>	74
<i>Shpresë .....</i>	75
<i>Shqipërisë .....</i>	76
<i>Shqiptare jam .....</i>	77
<i>Stinët e harruara .....</i>	78
<i>Suksesi.....</i>	79
<i>Testamenti i jetës.....</i>	80
<i>Ti je e fortë .....</i>	81

<i>Tinguj përtej horizontit</i> .....	82
<i>Trëndafili</i> .....	83
<i>Trëndafili i vëshkur</i> .....	84
<i>Unë do ja dal</i> .....	85
<i>Unë</i> .....	86
<i>Vajzë</i> .....	88
<i>Vendi im</i> .....	89
<i>Vetë i shërova plagët</i> .....	90
<i>Violina</i> .....	91
<i>Viti i 2022-të</i> .....	92
<i>Vlerat e nënës</i> .....	93
<i>Ëjet dëshmitar</i> .....	94
<i>Zemër</i> .....	95
<i>Kurbeti</i> .....	96
<i>Mes poezive të poetes Elisa Iqazi</i> .....	97



## *Elisa Iljazi*

*Është nxënëse në vitin e dytë në Shkollën e mesme ekonomike “8 Shtatori” në Tetovë. Arsimin fillor e ka kryer në ShfK “Gjergj Kastriot Skënderbeu” në f. Gjermë. Krijimet e para poetike i ka të postuara në rrjetet sociale, kurse librin e parë me poezi “Lulja e rinisë” e ka promovuar më 27. 07. 2022 në Qendrën për Kulturë në Tetovë. “Çelësi i lumturisë” është libri i dytë i Elisë me të cilin prezantohet para lexuesëve.*